REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DEÇAN

**Zyra e Kryetarit të Komunës**

Nr. 02_____/2026

| | |
|---|---|
| **Datë/Data** | **15.07.2026** |
| **Për/To/Za** | Bashkim Ramosaj- Kryetar i Komunës<br>Komandantin e Stacionit Policor-Deçan, z.Xhem Muriqi<br>Xhavit Nimanaj- Udhëheqës i Sektorit Kundër Dhunës në Familje<br>Tringa Dreshaj- OSBE<br>Arlinda Gacaferi- Prokuria Themelore Peje<br>Demë A. Hasanaj-Zyra për Mbrojtje të Viktimave<br>Flutura Berbati-Zena – Zyra për Ndihmë Juridike Falas<br>Nusret Pepaj- Qendra për Shëndetin Mendor Pejë<br>Drita Hakaj- Udhëheqëse e Shërbimit Sprovues Pejë<br>Hasije Islami- Këshilltare e Lartë Juridike<br>Ali Tahirsylaj- Qendra për Punë Sociale<br>Ajne Iberhysaj – Zyrtare për Barazi Gjinore<br>Besnik Hulaj – Drejtoria Komunale për Arsim<br>Agnesa Vokshi- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale<br>Shaban Pejqinoviq- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim<br>Ardita Ramizi –Bala – Strehimorja në Pejë<br>Leonora Ukëhajdaraj- Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport<br>Edona Kameraj- Zyra për Informim |
| **Nga/from/Od** | Ajne Iberhysaj- U.D Zyrtare për Barazi Gjinore |
| **Tema/Subject/Subjekat** | **Procesverbal i takimi i II-të i Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje** |

Zyra për Barazi Gjinore ka mbajt takimin e radhës të Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje të radhës më datën **15 korrik 2026 në ora 11:00-12:00** në Katin e Dytë të Komunës salla e konferencave. **<u>Tema e takimit</u>**: Trajtimi i rasteve të dhunës emocionale dhe psikologjike, ligjëron Sandra G.Zakowski Ph.D- Profesoreshe e Psikologjisë Klinike në Illinois.

**Takimi i II-të i Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje**

Trajnim për trajtimin e rasteve të dhunës psikologjike




Zyra për Barazi Gjinore të Komunës së Deçanit bashkëpunim me Shtëpinë e Sigurt në Pejë, kemi organizuar trajnimin me temën "Trajtimi i rasteve të dhunës psikologjike", me pjesëmarrjen e anëtarëve të Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës me Bazë Gjinore në Komunën e Deçanit gjithsej morën pjesë 15 veta (sipas gjinisë 11 gra dhe 4 burra) .

Trajnimi u ligjërua nga Sandra G. Zakowski, Ph.D., psikologe klinike e licencuar dhe profesoreshë e Psikologjisë Klinike në Illinois School of Professional Psychology në Chicago, e cila prezantoi qasje profesionale dhe praktika bashkëkohore për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës psikologjike.

Përmes diskutimeve interaktive, analizës së rasteve praktike dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet pjesëmarrësve, u trajtuan sfidat dhe praktikat më të mira në adresimin e dhunës psikologjike. U theksua domosdoshmëria e ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve profesionale dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, duke vlerësuar se trajnime të tilla janë thelbësore për ofrimin e mbrojtjes dhe mbështetjes sa më efektive për viktimat e dhunës.



Zyra për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryetarit shpreh mirënjohje të veçantë për Sandra G. Zakowski, Ph.D., për profesionalizmin, ekspertizën dhe kontributin e saj në realizimin e këtij trajnimi, si dhe falënderon të gjithë anëtarët e Mekanizmit Koordinues për pjesëmarrjen aktive dhe angazhimin e tyre në forcimin e mekanizmave institucionalë për parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore.

Bashkëpunimi, koordinimi dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale mbeten themeli i një sistemi mbrojtës që garanton siguri, dinjitet dhe mbështetje për çdo viktimë.

https://www.facebook.com/search/top?q=komuna%20e%20de%C3%A7anit&locale=en_GB

## Rekomandimet e takimit

- Të vazhdohet me organizimin e trajnimeve të rregullta për anëtarët e Mekanizmit Koordinues, me fokus të veçantë në identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e dhunës psikologjike.
- Të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional në identifikimin, referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore.
- Të zhvillohen protokolle dhe praktika të përbashkëta për trajtimin e rasteve, duke garantuar qasje të koordinuar, profesionale dhe të orientuar drejt nevojave të viktimave.
- Të rritet shkëmbimi i informacionit dhe përvojave profesionale ndërmjet institucioneve dhe organizatave që janë pjesë e Mekanizmit Koordinues.
- Të identifikohen në mënyrë të hershme shenjat e dhunës psikologjike dhe të rritet ndërgjegjësimi i profesionistëve për format e ndryshme të saj, përfshirë kontrollin, manipulimin, kërcënimet dhe izolimin.
- Të planifikohen aktivitete të përbashkëta për parandalimin e dhunës dhe ngritjen e vetëdijes në komunitet dhe shkolla.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIC OF KOSOVA**
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA E DEÇANIT**
**MUNICIPALITY OF DEÇAN**
**OPSTINA DEÇAN**

Lista e pjesëmarrësve për datën **20 korrik 2026 në ora 10:00-15:00** në Katin e Dytë të Komunës salla e konferencave

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Institucioni | *Email-i/ nr. tel* | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | FITORE HULAJ | KRYETARE - AGK-së DEÇAN | hulajfitore@gmail.com 044 993 454 | [signature] |
| 2 | Esa Audimetaj | studente | esaaudimetaj@gmail.com 049778392 | [signature] |
| 3 | Alvina Osaj | Studente në UP | alvinaosaj1@icloud.com 045-286-335 | [signature] |
| 4 | Hajrije Hasanmetaj | K.K. Deçan | Hajrije.Hasanmetaj@rks-gov.net | [signature] |
| 5 | Fitore Kuçi | KK. Deçan | fitore.kuci@rks-gov.net | [signature] |
| 6 | SHABAN PEJÇINOVIÇ | KK. Deçan | shaban.pejcinovic@rks-gov.net | [signature] |
| 7 | Drim Baloj | K.K. Deçan | drim.baloj@rks-gov.net | [signature] |
| 8 | Xufe Qufaj | KK. Deçan | xufe.qufaj@rks-gov.net | [signature] |
| 9 | Ajne Ibërhysaj | U.D. Berati Gjinaj | ajne.iberhysaj@rks-gov.net | [signature] |
| 10 | Selim Lokaj | Asistent në zyre të k. komunal | selim.lokaj@rks-gov.net | [signature] |
| 11 | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 12 | Muje Sejfijaj | KK. DEÇAN | 045 959 097 | |
| 13 | Etleva Zeneli | QKSGJ | etlevazeneli@gmail.com | |
| 14 | Leandra Povataj | Studente | leandrapovataj@gmail.com | |
| 15 | | | | |
| 16 | | | | |
| 17 | | | | |
| 18 | | | | |
| 19 | | | | |
| 20 | | | | |
| 21 | | | | |
| 22 | | | | |
| 23 | | | | |
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |